

BURSA SHQIPTARE E ENERGJISË ELEKTRIKE - ALPEX SHA

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM***(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)***OBJEKTI I PROCEDURËS:****“Shërbimi për menaxhimin e informacionit të brendshëm konfindencial (27001)”.****KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):**

48732000-8 - Paketa software për siguri të dhënash,

48780000-9 - Paketa software për sisteme, ruajtje dhe menaxhim përmbajtje

VLERA E FONDIT LIMIT:**1,400,000.00 (një milion e katërqind mijë) Lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor **Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX SHA** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10;*b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale: u arsyetua që OE duhet të paraqesë Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit si dhe Sigurimin e Ofertës, në ditën e hapjes së ofertës sipas Shtojcave të DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe nenin 82 të LPP (të ndryshuar), nenit 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2.2 Në lidhje me kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Në përmbushje të kapacitetit ekonomik dhe financiar, operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar xhiro minimale vjetore, në një vlerë të paktën prej 560,000.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

Ky kriter konsiderohet i përmbushur nëse OE ofertues arrin vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Si provë për plotësimin e këtij kriteri kualifikues, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë kopje të deklarates të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP të ndryshuar, si dhe nenin 43 dhe neni 55, pika 4, paragrafi 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, kërkohet që OE ofertues të provojë se disponon kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare për ta realizuar atë në kohë dhe në përputhje me termat e referencës të kërkuara. OE ofertues duhet të ketë disponibilitetin e duhur ekonomik dhe për këtë qëllim, është argumentuar se vlera e xhiros duhet të jetë 40% e fondit limit, përkatësisht në vlerën 560,000.00 (pesëqind e gjashtëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH, gjatë tre viteve të fundit financiare.

2.3 Përsa i përket aftësive teknike dhe profesionale të operatorëve ekonomik, u arsyetua që

ofertuesi duhet të tregojë se i zotëron këto aftësi dhe është në gjendje ta kryej kontratën objekt prokurimi. Në lidhje me këtë u arsyetua dhe argumentua se Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme:

2.3.1 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes të njoftimit të kontratës, shërbime të ngjashme lidhur me Çertifikatat Iso, me një vlerë jo më të vogël se 280,000.00 (dyqind e tetëdhjetë mijë) Lekë pa TVSH.

- Kur OE ka realizuar kontrata me një ent publik, kërkohen vërtetime të lëshuara nga ky i fundit, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave/shërbimeve të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe nenit 41 pika 3 dhe neni 55 pika 4/b të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Duke marrë në konsideratë shërbimet objekt procedure prokurimi, është menduar se vlera e kërkuar që OE ofertues të ketë bërë me kontrata të ngjashme, të jetë afër limitit maksimal në mënyrë që AK të ketë sigurinë dhe besueshmërinë që OE ofertues mund të realizojë kontratën objekt prokurimi pa patur pengesa të ndryshme që do të ndikonin në ecurinë e punës së AK.

2.3.2 *Operatori Ekonomik ofertues duhet të ketë minimalisht në stafin e tij me kontratë të vlefshme pune/bashkëpunimi 2 ekspertë për standartin ISO/IEC 27001:2022, pasi duhet të bëhet integrimi i tij në sistemin e menaxhimit, trajnimit i stafit. Ekspertët duhet të kenë kualifikimet e mëposhtme:*

2 (dy) Ekspertë lidhur me Ndërtimin e Sistemit, Trajnimin e Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit, ISO/IEC 27001:2022.

Ekspertët duhet të dëshmojnë kompetencën dhe eksperiencën përkatëse përmes:

- Të jetë i certifikuar si “Menaxher i Sigurisë së Informacionit”, Certifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar në përputhje edhe me kërkesat e Standartit ISO/IEC 17024 për certifikim personeli.
- Të ketë eksperiencë lidhur me procesin e Trajnimit ISO/IEC 27001:2022 duke dëshmuar që është jo më pak se 3 vjet trajner në Trupa certifikuese të akredituar sipas ISO 17021.
- Të jetë i trajnuar për Sigurinë Kibernetike.
- Të zotërojë minimalisht një Diplomë Universitare.

Për secilin anëtar të stafit operatori ekonomik duhet të paraqes:

1. CV
2. Diplomën Universitare
3. Kontratën e Punës/Bashkëpunimit
4. Certifikatat/Diplomat Përkatese

Për pikën si më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës Nr. 10.

Ndërsa operatori ekonomik fitues duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit, të gjithë dokumentacionin provues të kërkuar si më sipër.

Argumentimi: Kërkesa për stafin e nevojshëm për kryerjen e shërbimit objekt procedure prokurimi bazohet në pikën 4, të nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar dhe pikën 4/c, të nenit 41 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky numër punonjësish konsiderohet minimal për shërbimin e kërkuar objekt kontrate.

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues që do të realizojë këtë kontratë, duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikatat përkatese të vlefshme ISO, të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- ISO 9001: për Sistemin e menaxhimit të cilësisë, që ka lidhje me objektin e prokurimit.
- ISO/IEC 27001:2022 “Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit”.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me parashikimet e nenit 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, nenit 44, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, si dhe në bazë Ligjit Nr. 116/2014

“Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku përcaktohet se këto Çertifikata duhet të jenë të lëshuara nga organizma certifikues të akredituar, me qëllim që enti prokurues të krijojë sigurinë që operatorët ekonomik ofertues i kanë kapacitetet teknike lidhur me aftësinë e tyre për të kryer shërbimin objekt kontrate.

- Standardi i cilësisë ISO 9001: është sot referimi i njohur në nivel ndërkombëtar, për certifikimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë të kompanive të të gjithë sektorëve dhe të gjithë përmasave. Ky kriter kërkohet nga AK me qëllim për të vërtetuar cilësinë e shërbimit dhe të garantojë realizimin në kohë, me sukses dhe me cilësi sipas standardeve ndërkombëtare të objektit të kontratës.
- Kërkesa për paraqitjen e certifikatës ISO/IEC 27001:2022 – Sistemi i Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit vendoset për të garantuar që operatori ekonomik disponon procese, politika dhe kontrole të dokumentuara për menaxhimin e sigurisë së informacionit, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Ky kriter është i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi gjatë zbatimit të saj operatori ekonomik mund të ketë akses, të përpunojë ose të administrojë informacione, sisteme ose të dhëna që kërkojnë mbrojtje nga akses i paautorizuar, humbja, ndryshimi ose komprometimi.

Përmes kësaj certifikate sigurohet që operatori ekonomik zbaton një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit bazuar në vlerësimin e rreziqeve, kontrollin e aksesit, menaxhimin e incidenteve, vazhdimësinë e biznesit dhe përmirësimin e vazhdueshëm të masave të sigurisë, duke ulur rrezikun operacional dhe duke garantuar besueshmërinë gjatë ekzekutimit të kontratës.

Për rrjedhojë, kërkesa për certifikimin ISO/IEC 27001:2022 është proporcionale me natyrën e kontratës, shërben për mbrojtjen e informacionit dhe interesit publik dhe synon të sigurojë që kontrata të realizohet nga një operator ekonomik që zbaton standarde të njohura ndërkombëtarisht në fushën e sigurisë së informacionit.

2.3.4 Në funksion të plotësimit të Shtojces 10 “Formulari përmbledhes i vetëdeklarimit” Operatori Ekonomik ofertues duhet të japë të dhëna të qarta si Emër, Mbiemër, Atësi, Amësi, Datëlindje, Vendlindje, Numër Personal, si dhe kopje të skanuar të dokumentit të identifikimit (shqiptar ose të huaj), për Administratorin/Administratorët e shoqërisë, Ortakun/Ortakët e shoqërisë, përfaqësues të ndryshëm të posaçëm të shoqërisë, drejtues të ndryshëm të shoqërisë.

Argumentimi: Ky kriter vendoset referuar njoftimit të përbashkët Nr. 1155 prot, datë 01.02.2019, të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe të Ministrisë së Drejtësisë Nr. 1001/1 prot, datë 01.02.2019, sipas parashikimeve të nenit 76, pika 1, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, Autoriteti Kontraktor ALPEX SHA ka detyrimin e verifikimit të personave të cilët janë në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose

ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik.

Per këtë arsye, verifikimi i këtyre personave kërkon të dhëna të sakta si emër, mbiemër, atësi, amësi, vendlindje, datëlindje e numrin personal të personit.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shenim:

- i. *Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, në të gjithë rastet kur në dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike dhe Termat e Referencës, janë hartuar nga specialistet e fushës, duke marrë në konsideratë nevojat e Autoritetit Kontraktor, për mallrat dhe shërbimet objekt procedure prokurimi, duke përllogaritur sasi të nevojshme, karakteristikat e duhura dhe standardet e duhura kombëtare dhe ndërkombëtare, sipas parashikimeve të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

Termat e Referencës janë hartuar në përputhje me nevojat funksionale dhe rregullatore të ALPEX SHA, e cila, në bazë të VKM nr. 553, datë 15.07.2020, të ndryshuar me VKM nr. 761, datë 12.12.2022, është klasifikuar si infrastrukturë kritike e informacionit. Për rrjedhojë, ALPEX ka detyrimin të zbatojë masa të avancuara për mbrojtjen e informacionit dhe të forcojë kapacitetet e saj në fushën e sigurisë së informacionit.

Objekti i kontratës synon ngritjen, implementimin dhe certifikimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) sipas standardit ISO/IEC 27001:2022, duke përfshirë analizën e boshllëqeve, hartimin e dokumentacionit, trajnimin e stafit, implementimin e kërkesave të standardit, auditimet e brendshme dhe mbështetjen gjatë auditimit certifikues nga një trupë e akredituar.

Termat e Referencës janë strukturuar sipas fazave logjike të implementimit të një SMSI, në përputhje me kërkesat e standardit ISO/IEC 27001:2022 dhe praktikat më të mira ndërkombëtare, me qëllim që të sigurohet një zbatim i plotë, i qëndrueshëm dhe efektiv i sistemit. Kërkesat e përcaktuara janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, janë proporcionale me kompleksitetin e shërbimit dhe synojnë garantimin e një rezultati përfundimtar që përmbush kërkesat ligjore, rregullatore dhe operacionale të ALPEX.

Për këtë arsye, hartimi i këtyre Termave të Referencës është i domosdoshëm për përzgjedhjen e një operatori ekonomik me kapacitetet e nevojshme profesionale dhe teknike për realizimin me sukses të projektit dhe për arritjen e certifikimit ISO/IEC 27001:2022.

Kërkesat e përcaktuara janë proporcionale me objektin e kontratës dhe të nevojshme për realizimin e saj, pa krijuar kufizime të panevojshme për operatorët ekonomikë.